

VENDIM
Nr.23, datë 12.1.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE
NDËRMJET AUTORITETEVE TË STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT TË
DECENTRALIZUAR TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN, NË KUADËR TË
INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT (IPA), KOMPONENTI I: ASISTENCA E
TRANZICIONIT DHE FORCIMI INSTITUCIONAL¹**

(Ndryshuar me VKM nr.850, datë 14.12.2011; nr.707, datë 21.8.2013; nr.300, datë 23.5.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi

Ky vendim përcakton funksionet, përgjegjësitë, marrëdhëniet e ndërsjella që krijohen ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar (MD) të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti i parë:

Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional.

Vendimi u garanton autoriteteve të menaxhimit të decentralizuar ushtrimin e përgjegjësive të ngarkuara për menaxhimin, zbatimin dhe kontrollin e programeve të financuara nën IPA-n, edhe në rastet kur mes autoriteteve të përfshira në proces nuk ka lidhje hierarkike. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, këto autoritete krijojnë një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, standardet që duhen plotësuar dhe procedurat që duhen ndjekur, të cilat përcaktohen në manuallet e brendshme të procedurave.

2. Autoritetet dhe strukturat e IPA-së

a) Autoritetet e menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), do të jenë:

- i) Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (KKIPA/NIPAC);
- ii) Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA/CAO);
- iii) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO);
- iv) Zyrtari Autorizues i Programit (ZAP/PAO);
- v) Zyrtarët e lartë të programit në ministrinë e linjës (ZLP / SPOs).

b) Strukturat e menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), do të jenë:

- i) Fondi Kombëtar (FK/NF);
- ii) Zyra e NAO-së/ZKA-së;

¹ VKM nr. 23, datë 12.1.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4, datë 24 janar 2011.

VKM nr.850, datë 14.12.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, dhjetor 2011.

VKM nr.707, datë 21.8.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.145, datë 5 shtator 2013.

VKM nr.300, datë 23.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.78, datë 29 maj 2018.

iii) Struktura operative për implementimin e komponentit I (të parë) IPA;

iv) Autoriteti i auditit.

Struktura operative përbëhet nga zyra e KKIPA-së/NIPAC-së, Agjencia implementuese/ Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, ZLP-të / SPO-të, në ministritë e linjës, si dhe nga auditit i brendshëm, në ministritë e linjës dhe/ose institucioneve të tjera përfituese.

Autoriteti i auditit është një strukturë funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e sistemit të menaxhimit e të kontrollit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, miratuar me vendimin nr.1020, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së”.

Audituesit, gjatë kryerjes së detyrës, janë funksionalisht të pavarur dhe veprojnë në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Etikës të Agjencisë së Auditimit. Subjekti i audituar nuk mund të kundërshtojë, refuzojë apo pengojë misionin e auditit. Sipas objektit të veprimtarisë së auditimit, autoriteti i auditit ka të drejtë të kërkojë informacion dhe/ose akses mbi të gjitha të dhënat, asetet dhe personelin e subjektit të audituar. Subjekti i audituar duhet t'i sigurojë autoritetit të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar misionin e auditimit.

3. Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC)

a) Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (KKIPA/NIPAC) do të jetë ministri përgjegjës për integrimin europian.

b) KKIPA-ja/NIPAC-ja është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, i cili bazuar në pikën 2 të aneksit A të marrëveshjes kuadër (ligji nr.9840, datë 10.12.2007), do të jetë përgjegjës:

i) për të siguruar koordinimin e përgjithshëm të asistencës së IPA-së;

ii) për të siguruar partneritetet ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, dhe efektivitet të përdorimit të fondeve të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA, sipas përparësive të përcaktuara për integrimin europian.

c) NIPAC-ja/Ministri i Integritimit identifikon përparësitë për financim nga programi IPA, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore. Për përparësitë e identifikuar bëhen këshillime me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Ministrinë e Financave dhe më pas i paraqiten për miratim Komitetit të Planifikimit Strategjik. Ministria e Integritimit i përcjell Komisionit Europian përparësitë, të miratuara për financim nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

ç) KKIPA-ja/NIPAC-ja, brenda kompetencave të përcaktuara, si dhe asistuar nga zyra e KKIPA-së/NIPAC-së, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

i) programimin vjetor të asistencës në kuadër të komponentit I të IPA-së;

ii) Zbatimin dhe monitorimin në nivel programi e nivel projekti, për komponentët e IPA-s, dhe përgatitjen e raportit vjetor/final, të cilin KKIPA/NIPAC-ja do t'ua dërgojë Komisionit Europian dhe ZKA/NAO-së, bazuar në nenin 38 të marrëveshjes kuadër;

iii) përgatitjen e termave të referencës për ekspertët, të cilët do të kryejnë procesin e vlerësimit;

iv) Zyra e KKIPA-së/NIPAC-së, në ministrinë përgjegjëse për integrimin europian përgatit dhe zbaton manualin e brendshëm të procedurave, i cili miratohet nga KKIPA-ja/NIPAC-ja dhe konfirmohet nga ZKA-ja/NAO-ja.

d) Ministri i Integritimit emëron me urdhër të brendshëm strukturën përkatëse në Ministrinë e Integritimit për zyrën e KKIPA-së/NIPAC-së, e cila do të mbështesë në ushtrimin e funksioneve të KKIPA-së/NIPAC-së.

4. Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA/CAO)

a) Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA/CAO) do të jetë Ministri i Financave.

b) ZPA-ja/CAO-ja është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, i cili akrediton ZKA-në/NAO-në dhe strukturën e tij mbështetëse, zyrën e ZKA-së/NAO-së dhe Fondin Kombëtar (NF), për menaxhimin e decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të komponentëve të IPA-së, bazuar në kërkesat e përshkruara në pikën 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

c) ZPA-ja/CAO-ja kryen këto detyra:

i) nëpërmjet auditit të pavarur, kontrollojnë përmbushjen e kritereve të akreditimit nga ZKA-ja/NAO-ja, Fondi Kombëtar dhe zyra e ZKA-së/NAO-së, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 1 (c) të aneksit A, të marrëveshjes kuadër;

ii) pas akreditimit të ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe zyrës së ZKA-së/NAO-së, do të jetë përgjegjës për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe zyrës së ZKA-së/NAO-së, duke informuar për këtë Komisionin Europian, bazuar në pikën 1 (b) të aneksit A të marrëveshjes kuadër;

iii) të organizojë mbledhje të rregullta dhe këshillime me Autoritetin e Auditit për të siguruar funksionimin e rregullt të menaxhimit të decentralizuar të asistencës, në kuadër të komponentëve të IPA-së;

iv) miraton manualin e brendshëm të procedurave për ZPA-në/CAO-në, përgatitur nga Ministria e Financave, për realizimin e funksioneve të tij;

v) *Miraton manualin e brendshëm të procedurave për ZKA-në/NAO-në, për Fondin Kombëtar, për Zyrën e NAO-s, dhe për ZAP-në/PAO-në, përgatitur nga këta të fundit.*

ç) ZPA-ja/CAO-ja dhe ZKA-ja/NAO-ja miratojnë manualin e brendshëm të procedurave për strukturën operative.

5. Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO)

a) ZKA-ja/NAO-ja është zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave, i cili emërohet me urdhër nga ZPA-ja/CAO-ja.

b) *ZKA-ja/NAO-ja është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, që menaxhon veprimtarinë e Fondit Kombëtar, të cilit i është ngarkuar përgjegjësia për menaxhimin financiar të fondeve të Bashkimit Europian dhe Zyrës së NAO-s, së cilës i është ngarkuar përgjegjësia për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit.*

c) ZKA-ja/NAO-ja kryen edhe këto detyra:

i) Në mbështetje të pikës 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, është përgjegjës për legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit në përputhje me rregulloren e IPA-së;

ii) Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, në mbështetje të pikës 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, përdor kapacitetet e Fondit Kombëtar për menaxhimin financiar dhe kapacitetet e zyrës së ZKA-së/NAO-së, për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit;

iii) Pas konsultimit me KKIPA-në/NIPAC-në, cakton personin/at që do të kryejë/kryejnë funksionin e Zyrtarit Autorizues të Programit (ZAP/PAO), i cili drejton Agjencinë Implementuese.

ZKA-ja/NAO-ja informon Komisionin Europian për çdo zëvendësim të personit që kryen këtë funksion;

iv) Është përgjegjës për akreditimin e strukturës operative për zbatimin e komponentit të parë të IPA-së, dhe, bazuar në nenin 11 të marrëveshjes kuadër, informon Komisionin Europian për këtë akreditim, si dhe akrediton strukturën operative pasi të sigurohet, bazuar në vlerësimin e një auditimi të pavarur, që kërkesat e parashtruara në nenin 9 të marrëveshjes kuadër, janë përmbushur;

v) Pas akreditimit të strukturës operative sipas nënndarjes iv të shkronjës “c”, më sipër, është përgjegjës për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit, si dhe për informimin e ZPA-së/CAO-së dhe të Komisionit Europian, në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër;

vi) Monitoron funksionimin e menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit brenda strukturës operative dhe, nëse vëren dobësi në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit, informon drejtuesit e organeve të strukturës operative për këtë, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave të përshtatshme korrigjuese. Nëse drejtuesit e organeve të strukturës operative nuk i zbatojnë masat e rekomanduara, ZKA-ja/NAO-ja informon ministrin përkatës;

vii) Mund të revokojë akreditimin e strukturës operative nëse strukturat përkatëse nuk eliminojnë dobësitë në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit brenda afateve të përcaktuara;

viii) Në mënyrë që të monitorohet me sukses funksionimi i sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, mund të angazhojë Autoritetin e Auditit, i cili do të dorëzojë pranë ZKA-së/NAO-së planin vjetor të punës, raportin vjetor për veprimtaritë e auditit, si dhe një mendim auditit vjetor;

ix) Kur është e nevojshme, mund të angazhojë auditues të jashtëm të pavarur për të realizuar audit shtesë të të gjitha institucionet e përfshira në menaxhimin e decentralizuar të fondeve të IPA-së, për të siguruar një funksionim të frytshëm dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit në përputhje me rregulloren e IPA-së;

x) Do të jetë përgjegjës për identifikimin e çdo parregullsie brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar dhe informon Komisionin Europian, përkatësisht, ZKA-në/NAO-në, bashkëpunon me strukturën që do të krijohet për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe hetimin e parregullsisë, Shërbimin e Koordinimit Kundër Mashtrimit (AFCOS). Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet ZKA-së/NAO-së dhe AFCOS rregullohen me një memorandum bashkëpunimi;

xi) Do të dorëzojë një deklaratë vjetore garancie pranë Komisionit Europian, në përputhje me nenin 17 të marrëveshjes kuadër. Nëse nuk ka evidenca për funksionimin e frytshëm të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, si dhe për legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve kryesore, kërkuar këto nga deklaratat e garancisë, NAO-ja informon Komisionin Europian dhe ZPA-në/CAO-në për arsyet dhe pasojat e mundshme të çështjes në fjalë, si dhe për masat korrigjuese, të ndërmarra për kapërcimin e situatës dhe për mbrojtjen e interesave të komunitetit;

xii) Siguron bashkëfinancimin e nevojshëm kombëtar në përputhje me marrëveshjet përkatëse financiare të IPA-së, në mënyrë që të pasqyrohen në buxhetin vjetor të Republikës së Shqipërisë;

xiii) Dërgon në Komisionin Europian një parashikim të aplikimeve të pagesave të pritshme për çdo vit financiar dhe për vitet e ardhshme financiare brenda datës 28 shkurt të çdo viti;

xiv) Siguron që sistemi i raportimit financiar të Komisionit Europian (I-Perseus) të përditësohet rregullisht dhe procedurat raportuese të respektohen nga Fondi Kombëtar dhe Agjencia Implementuese;

xv) Merr pjesë në Komitetin e Monitorimit të IPA-së dhe Komitetin e Monitorimit të Asistencës së Tranzicionit dhe Forcimit Institucional (TAIB);

xvi) *Miraton manualat e brendshme të procedurave për Fondin Kombëtar, Zyrën e NAO-s, ZAP-në/PAO-në dhe Agjencinë Implementuese, si dhe konfirmon manualat e brendshme të procedurave të zyrës së KKIPA-së/NIPAC.*

xvii) Së bashku me ZAP-në/PAO-në, miraton manualin e brendshëm të procedurave për veprimtarinë përkatëse të ZLP-së/SPO-së, në kuadër të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian për komponentin e parë të IPA-së, pasi ato janë miratuar nga ministria e linjës, si dhe i dërgon këto manuale (përmendur në nënndarjen xvi, më sipër) për konfirmim e ZPA-ja/CAO-ja.

ZKA-ja/NAO-ja ushtron të gjitha të drejtat si nëpunës i parë autorizues në lidhje me fondet e Bashkimit Europian, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10 294, datë 1.7.2010 "Për inspektimin financiar publik", dhe në përputhje të plotë me nënndarjet 4 e 5 të shkronjës "a" të aneksit A të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit financiar për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të paraaderimit (IPA).

6. Zyra e ZKA-së/NAO-së

a) Zyra e ZKA-së/NAO-së është strukturë në Ministrinë e Financave për të mbështetur ZKA-në/NAO-në në zbatimin e funksionit të dytë të tij, për monitorimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit të IPA-së, bazuar në pikën 4 (b) të aneksit A të marrëveshjes kuadër, në përputhje me pikën 4 të nenit 25 të rregullores IPA 718/2007.

b) Zyra e ZKA-së/NAO-së mbështet ZKA-në/NAO-në në detyrat, si më poshtë vijon:

i) Miratimin, monitorimin dhe pezullimin/anulimin e akreditimit të strukturës operative;

ii) Siguron funksionimin e frytshëm të sistemeve të menaxhimit të asistencës në përputhje me rregulloren IPA-së;

iii) Siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm për menaxhimin e fondeve është efektiv dhe i frytshëm;

iv) Siguron rregullsinë dhe saktësinë e sistemit të raportimit dhe të informacionit;

v) Ndjek zbatimin e gjetjeve dhe të rekomandimeve të Autoritetit të Auditit, në përputhje me pikën 1 të nenit 30 të rregullores IPA 718/2007.

c) Drejtuesi i zyrës së ZKA-së/NAO-së kryen këto detyra:

- i) I raporton ZKA-së/NAO-së;
 - ii) Bashkërendon punën për veprimtaritë e ZKA-së/NAO-së për të gjithë komponentët e IPA-së;
 - iii) Përgatit materialet e duhura për këto veprimtari të përmendura më sipër.
- ç) Gjatë përbushjes së detyrave e të përgjegjësive respektive, stafi i zyrës së ZKA-së/NAO-së zbaton manulet e brendshme të procedurave të ZKA-së/NAO-së, të miratuara nga ZPA-ja/CAO-ja dhe ZKA-ja/NAO-ja.

Me kërkesë të ZKA-së/NAO-së, Zyra e ZKA-së/NAO-së kryen kontrolle në vend në Drejtorinë e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, në varësi të ministrit përgjegjës për financat., agjencitë implementuese, si dhe strukturat e IPA-s, në ministritë e linjës/institucionet përfituese, për kontrollin dhe monitorimin më të frytshëm të projekteve të financuara nën IPA-në, si dhe për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve lidhur me to, bazuar në shkronjën "a" të pikës 4 dhe pikën 5 të aneksit A të Marrëveshjes kuadër, në përputhje me pikën 3 të nenit 25 të rregullores IPA 718/2007.

7. Fondi Kombëtar (NF)

a) Fondi Kombëtar është një strukturë qendrore e thesarit, në Ministrinë e Financave, njësia e vetme nëpërmjet së cilës fondet e parazgjerimit nga Komisioni Europian do t'i transferohen Republikës së Shqipërisë, bazuar në pikën 4 (a) dhe pikën 5 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

b) Roli dhe përgjegjësitë e Fondit Kombëtar janë pasqyruar në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.

c) Drejtuesi i Fondit Kombëtar raporton direkt te ZKA-ja/NAO-ja dhe është përgjegjës për funksionimin dhe realizimin e veprimtarisë së Fondit Kombëtar.

ç) Fondi Kombëtar, i drejtuar nga ZKA-ja/NAO-ja, është përgjegjës për menaxhimin financiar të fondeve të IPA-së dhe kryen, brenda kompetencave të tij, detyrat e mëposhtme:

- i) Çel dhe menaxhon llogaritë dhe nënlogaritë bankare;
- ii) Aplikon për fonde pranë Komisionit Europian;
- iii) Miraton transferimin e fondeve nga Komisioni Europian te strukturat operative ose te përfituesit përfundimtarë të fondeve të IPA-së;
- iv) Dërgon raporte financiare pranë Komisionit Europian.

d) Shfuqizuar.

dh) Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për menaxhimin financiar të IPA-së, Fondi Kombëtar bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë (BSH), ku ZKA-ja/NAO-ja hap llogari bankare në monedhë të huaj për të transferuar fondet nga Komisioni Europian për secilin komponent të IPA-së. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar, Agjencisë Implementuese dhe BSH-së rregullohen me një marrëveshje të veçantë që përcakton afatet dhe kushtet për përdorimin e llogarive bankare në monedhë të huaj, të çelura në Bankën e Shqipërisë.

e) Ndarja e roleve dhe përgjegjësive ndërmjet ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe strukturës operative, brenda menaxhimit të decentralizuar të IPA-së, komponenti I, dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella përcaktohen në një marrëveshje zbatimi ndërmjet ZKA-së/NAO-së dhe ZAP-së/PAO-së, ku përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese, procedurat e transferimit dhe metodat e përdorimit të fondeve, dispozitat për bashkëfinancimin, mekanizmat e kontrollit financiar, menaxhimin e llogarive bankare, kontabilitetin dhe auditimin.

8. Zyrtari Autorizues i Programit (ZAP/PAO)

a) Zyrtari Autorizues i Programit (ZAP/PAO) është një zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave, emëruar nga ZKA-ja/NAO-ja pas konsultimit me KKIPA-në/NIPAC-në. ZAP-ja/PAO-ja drejton Agjencinë Implementuese për zbatimin e Komponentit të Parë të IPA-së dhe përgjigjet te ZKA-ja/NAO-ja për përbushjen në kohën e duhur dhe me efikasitet të detyrimeve të përcaktuara në pikën 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

b) ZAP-ja/PAO-ja është përgjegjës për veprimtarinë e Agjencisë Implementuese dhe ZLP-ve/SPO-ve, të emëruar në ministritë e linjës apo në institucione të tjera, përfituese të IPA-së.

c) ZAP/PAO-ja është përgjegjëse për të informuar KKIPA/NIPAC-në për zbatimin e kontratave dhe për t'i siguruar ZKA/NAO-së ligjshmërinë e rregullsinë e shpenzimeve apo aspekteve të tjera

financiare që lidhen me zbatimin e kontratave:

9. Zyrtarët e Lartë të Programit (ZLP/SPO-s)

a) ZLP/SPO-ja është një person i caktuar nga ministri i linjës apo institucioni përfitues, dhe i emëruar nga ZAP/PAO-ja. ZLP/SPO-ja është përgjegjëse për aspektet teknike të projekteve që do të zbatohen në ministrinë e linjës apo në institucionin përfitues dhe asiston ZAP/PAO-në në përgatitjen dhe zbatimin e kontratës në kohë e në mënyrë të përshtatshme.

b) ZLP/SPO-të janë përgjegjës për programimin, zbatimin dhe monitorimin e kontratave e projekteve ku ministrinë ose institucionet përkatëse janë përfituesit, sipas komponentit I. ZLP/SPO-të bashkërendojnë punën brenda ministrisë ose institucionit përkatës dhe raportojnë te KKIPA/NIPAC-ja për funksionet e programimit, të tilla si: analizat sektoriale, identifikimi i projektit, përgatitja e fishave të projekteve dhe monitorimi i projekteve.

c) ZLP-të/SPO-të kryejnë detyrat e mëposhtme:

i) Përgjigjen për aspektet teknike të implementimit të projekteve, të financuara në kuadër të komponentit të parë të IPA-së.

ii) Informojnë ZAP-në/PAO-në për çdo dyshim për ekzistencën e ndonjë parregullsie apo të çdo lloj parregullsie të përcaktuar që evidentohet gjatë zbatimit të projekteve të IPA-së;

iii) Bashkëpunojnë rregullisht me auditin e brendshëm gjatë zbatimit të projekteve të IPA-së dhe informojnë ZAP-në/PAO-në përsa i përket rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe zbatimit të tyre;

iv) Informojnë ZAP-në/PAO-në për problemet apo rreziqet e mundshme që lidhen me zbatimin e projekteve të IPA-së;

v) Mbështetur në marrëveshjen operacionale të nënshkruar ndërmjet ZAP-së/PAO-së dhe SPO-ve, për zbatimin e projekteve të IPA-së, përgjigjen te ZAP-ja/PAO-ja për kryerjen e detyrave të ngarkuara.

vi) Menaxhojnë strukturat e IPA-së në ministrinë e linjës / institucionet përfituese, që do të mbështesin ZLP-të/SPO-të gjatë kryerjes së rolit dhe detyrave që lidhen me zbatimin e projekteve të IPA-së.

vii) Janë përgjegjës për informimin në kohë të ZAP-ja/PAO-ja për çdo ndryshim përsa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore në strukturën e IPA-së që ai/a jo drejton.

10. Struktura operative për zbatimin e komponentit I të IPA-së (TAIB)

a) Bazuar në pikën 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër të IPA-së, struktura operative për zbatimin e komponentit I të IPA-së përfshin:

i) Agjencinë Implementuese, drejtuar nga ZAP-ja/PAO-ja. Për komponentin I të IPA-së Agjencia Implementuese është *Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, në varësi të ministrit përgjegjës për financat;*

ii) Strukturat e IPA-së në ministrinë e linjës dhe në institucionet e tjera që implementojnë projekte të financuara nga komponenti I, IPA, të drejtuara nga ZLP-të/SPO-të;

iii) Auditin e brendshëm në ministrinë e linjës dhe/ose institucionet e tjera që implementojnë projekte të financuara nga komponenti I, IPA;

iv) Zyra e KKIPA-së/NIPAC-së.

11. Përgjegjësitë e strukturës operative

a) Agjencia Implementuese/ *Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, në varësi të ministrit përgjegjës për financat., është përgjegjëse:*

i) *Kryerjen e procedurave të tenderimit, kontraktimit, regjistrimin e transaksioneve në sistemin e kontabilitetit, kryerjen e pagesave dhe monitorimin e kontratave të lidhura për projektet e financuara nën komponentin I të IPA-s, dhe kontrollin e brendshëm, bazuar në kërkesat e sistemit të menaxhimit të decentralizuar të IPA-s;*

ii) për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve të sistemit të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së në Republikën e Shqipërisë, të financuara nga komponenti I, IPA;

iii) për kryerjen e kontroleve në vend dhe, kur vëren mangësi në veprimtari, marrjen e masave me qëllim eliminimin e mangësive për të siguruar zbatimin efektiv dhe në kohë të projekteve nga

strukturat e IPA-së;

iv) për nëpunësit e CFCU-së, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, zbatojnë dispozitat e manualit të brendshëm të procedurave për CFCU-në, të miratuara nga ZKA-ja/NAO-ja dhe të konfirmuara nga ZAP-ja/PAO-ja.

b) Strukturat e IPA-së, që menaxhohen nga ZLP-të/SPO-të, janë përgjegjëse për:

i) *Programimin, zbatimin dhe monitorimin e kontratave e projekteve financuar nga komponenti I i IPA-së, si dhe përmbushjen e funksioneve që kanë të bëjnë me zbatimin teknik të kontratave e projekteve.*

ii) zbatimin e dispozitave të manualit të brendshëm të procedurave të ZLP-ve/SPO-ve nga nëpunësit në strukturat përkatëse të IPA-së, gjatë kryerjes së detyrave të tyre lidhur me implementimin e projekteve, financuar me fondet IPA.

c) Audit i Brendshëm në ministritë e linjës dhe/ose në institucione të tjera që implementojnë projekte të financuara nga komponenti I, IPA, është përgjegjës për auditimin e këtyre projekteve dhe strukturave të IPA-së në këto institucione, bazuar në planin vjetor e strategjik të punës, i cili, pasi miratohet nga ministri i linjës ose titullari i institucionit, dërgohet te ZKA-ja/NAO-ja. ZKA-ja/NAO-ja nxjerr instruksione për të gjitha strukturat e IPA-së, lidhur me përgatitjen e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve e të gjetjeve të auditit të brendshëm, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar të auditit.

ç) *Zyra e KKIPA/NIPAC-së është strukturë në ministrinë përgjegjëse për integrimin europian, e krijuar me urdhër të ministrit të integritit, për të mbështetur KKIPA/NIPAC-në në ushtrimin e funksioneve të programimit, implementimit, monitorimit e të vlerësimeve interim, dhe kryen këto detyra:*

i) *Për sa i përket programimit, kjo zyrë organizon procesin e programimit sipas manualit përkatës të programimit të KKIPA/NIPAC-së dhe Manualit të Programimit IPA, të Komisionit European. Gjithashtu, kjo zyrë dorëzon te KKIPA/NIPAC-ja draftin e fundit të projektfishave për programet në komponentin I të IPA-së.*

ii) *Për sa u përket implementimit të projekteve dhe programeve, kjo zyrë është përgjegjëse për të ndjekur, në bashkëpunim me ZLP/SPO-në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të përcaktuara, si dhe mënyrën e përdorimit të produkteve të kontratave.*

iii) *Për sa i përket monitorimit, kjo zyrë është përgjegjëse për përgatitjen e raporteve vjetore/përfundimtare për implementimin, organizimin e takimeve të Komitetit të Monitorimit IPA, dhe për veprimtaritë pasardhëse lidhur me këtë komitet. Lidhur me monitorimin e komponentit I të IPA-s, Zyra e KKIPA/NIPAC-së është përgjegjëse për përgatitjen e draftit vjetor të raportit të implementimit mbi programet kombëtare, organizimin e takimeve të komitetit të monitorimit për komponentin I të IPA-së, si dhe për monitorimin në nivel projekti dhe programi, bazuar në Manualin e Monitorimit dhe Vlerësimit.*

iv) *Lidhur me vlerësimin interim, zyra e KKIPA/NIPAC-së është përgjegjëse për përgatitjen e planit interim të vlerësimit për programet e komponentit I të IPA-së, si dhe dorëzimin e vlerësimeve interim pranë KKIPA/NIPAC-së, që ky i fundit e paraqet në Komitetin e Monitorimit IPA. Zyra e KKIPA/NIPAC-së përgatit termat e referencës për marrjen e vlerësuesve interim dhe shërben si pikë kontakti gjatë vlerësimeve interim.*

d) *Shfuqizuar.*

dh) Nëpunësit në zyrën e KKIPA-së /NIPAC-së, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, zbatojnë dispozitat e manualit të brendshëm të procedurave të zyrës së KKIPA-së /NIPAC-së, të cilat miratohen nga KKIPA-ja /NIPAC-ja dhe konfirmohen nga ZKA-ja/NAO-ja.

12. Komiteti i Monitorimit të IPA-së dhe Komiteti i Monitorimit të Komponentit I, IPA (TAIB)

a) Bazuar në nenin 36 të marrëveshjes kuadër, për menaxhimin e decentralizuar të IPA-së, krijohen:

i) Komiteti i Monitorimit të IPA-së për të gjithë komponentët e IPA-së;

ii) Komiteti i Monitorimit të Komponentit të Parë të IPA-së (TAIB).

b) Komiteti i Monitorimit të IPA-së është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të të gjithë asistencës së IPA-së, bazuar në nenin 36 paragrafi i tretë i marrëveshjes kuadër dhe në rregulloren operative të Komitetit të Monitorimit të IPA-së. Ky Komitet përbëhet nga përfaqësues të

Komisionit Europian, të ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar, KKIPA-së/NIPAC-së, ZAP-së/PA-së. Përfaqësues të Komisionit Europian dhe të KKIPA-së/NIPAC-së do të bashkëdrejtojnë Komitetin, ndërsa zyra e KKIPA-së/NIPAC-së do të kryejë funksionin e Sekretariatit të Komitetit dhe do të jetë përgjegjëse për përgatitjen dhe dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që do të diskutohet dhe do të rishikohet nga Komiteti.

c) Komiteti i Monitorimit të Komponentit I, IPA (TAIB) është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të programeve të komponentit I, IPA, në përputhje me rregulloren operative të Komitetit të Monitorimit Sektorial për komponentin I. Ky komitet përbëhet nga përfaqësues të Komisionit Europian, të ZKA-së/NAO-së, të Fondit Kombëtar, të KKIPA-së/NIPAC-së, nga Agjencia Implementuese, partnerë socialë dhe organizata të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e KKIPA-së/NIPAC-së do të drejtojnë Komitetin, ndërsa zyra mbështetëse e KKIPA-së/NIPAC-së, në Ministrinë e Integritit, do të kryejë funksionin e Sekretariatit të Komitetit dhe do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit që do të diskutohet dhe do të rishikohet nga Komiteti.

12/1. Komiteti Ndërmintor për Koordinimin e Programeve IPA:

i) Komiteti Ndërmintor për Koordinimin e Programeve IPA është një grup ndërinsitucional pune, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për integrimin europian, me urdhër të Kryeministrit, dhe ka për qëllim të shërbejë si mekanizëm koordinimi për monitorimin e zbatimit të projekteve dhe programeve IPA.

ii) Grupi ndërinsitucional i punës kryesohet nga KKIPA/NIPAC-ja dhe përbëhet nga ZKA/NAO-ja, ZAP/PAO-ja, zëvendësministri e ministrive të linjës të ngarkuar për të ndjekur programet IPA, ZLP/SPO-të e ministrive të linjës dhe/ose institucioneve të tjera, përfaqësues të Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, pranë Këshillit të Ministrave, dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave.

iii) Komiteti Ndërmintor për Koordinimin e Programeve IPA është përgjegjës për hartimin dhe rishikimin e planit të veprimeve/masave që duhen ndërmarrë për çdo projekt problematik të financuar nga programet IPA. Ky Komitet mund të organizojë inspektime në terren, për të monitoruar zbatimin e planit të veprimit.

iv) Në rastet e projekteve problematike, të cilat nuk marrin zgjidhje, Komiteti Ndërmintor për Koordinimin e Programeve IPA i propozon Komitetit të Planifikimit Strategjik marrjen e masave konkrete për institucionet përfituese.

v) Zyra e KKIPA/NIPAC-së do të shërbejë si sekretariat i Komitetit Ndërmintor për Koordinimin e Programeve IPA.

13. Ministrinë e linjës dhe strukturat e IPA-së

a) Ministri i linjës/drejtuës i institucionit përfitues cakton një person për kryerjen e funksionit të ZLP-së/SPO-së dhe e autorizon atë të nënshkruajë marrëveshjen operacionale me ZAP-në/PAO-në, si dhe akte të tjera që lidhen me projektet e financuara nga IPA-ja.

b) Ministri i linjës/drejtuës i institucioneve përfituese të IPA-së dhe ZLP-të/SPO-të respektivë, në bashkëpunim me ZPA-në/CAO-në duhet të organizojnë rregullisht mbledhje dhe të bashkëpunojnë rregullisht me ZKA-në/NAO-në, me drejtuesin e Fondit Kombëtar, me ZAP-në/PAO-në për kapërcimin në kohë të të gjitha dobësive të evidentuara gjatë procesit të implementimit të projekteve të financuara nga IPA-ja.

c) Ministrinë e linjës/drejtuës i institucioneve përfituese të IPA-së do t'u sigurojnë ZLP-ve/SPO-ve personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar, bazuar në analizën e ngarkesës së punës, si dhe në fondet e nevojshme për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA-ja, brenda buxhetit respektiv të ministrisë së linjës/ institucionit përfitues të IPA-së.

ç) Ministri i linjës/drejtuës i institucionit përfitues duhet të informojë ZAP-në/PAO-në për çdo zëvendësim të ZLP-ve/SPO-ve në institucionet e tyre, dhe të ZAP-së/PAO-së, ndryshim për të cilin duhet të informojë ZKA-në/NAO-në.

d) Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar të IPA-së në ministrinë e linjës do të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi brenda kompetencave, bazuar në marrëveshjen operacionale, ndërmjet PAO-së dhe SPO-ve, në marrëveshjen me KKIPA-në/NIPAC-në, si dhe në

rregulloren e brendshme të ministrisë përkatëse.

14.Dispozita kalimtare

a) Ministrinë dhe institucionet përfituese të IPA-së duhet të përshtasin rregulloret e brendshme të institucioneve të tyre përkatëse me masat e përcaktuara në këtë vendim për një periudhë 3-mujore, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

b) Vendimi nr.719, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha